

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR FAMILJEVE DHE KOMUNITETEVE ME BANIM TË PËRHershëM NË ZONAT RURALE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale. Konkretisht, ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, parashikon të drejtën e përdorimit mbi pyjet, si mundësinë e personit për ta përdorur pjesën e fondit pyjor kombëtar të dhënë në përdorim dhe për të gëzuar frytet që rrjedhin prej tij, në masën që ka nevojë për vete dhe për familjen e tij, përkundrejt punës së tij në kryerjen e shërbimeve përmirësuese të atij pylli, si dhe pa cënuar mundësinë që kanë pyjet dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Në lidhje me të drejtën e përdorimit, ligji parashikon se familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale kanë të drejtën e përdorimit të sipërfaqeve të fondit pyjor kombëtar në afërsi të fshatit për përbushjen e nevojave vetjake, por nuk përcakton kriteret dhe rregullat për dhënien në përdorim. Për rrjedhojë bazuar në autorizimin ligjor të nenit 12 pika 4 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, nëpërmjet këtij projektvendimi parashikohen kriteret dhe rregullat për dhënien në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar.

Objktivi që synohet të arrihet është përcaktimi i kritereve të vecanta dhe rregullave të unifikuara për dhënien në përdorim të fondit pyjor për nevojat e familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale, duke marrë në konsideratë se pyjet janë një burim ekonomik që sjellin zhvillim, punësim, për të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë (bujqësi, industri, energji, turizëm, argëtim, etj.).

Historikisht, pjesa më e madhe e familjeve dhe komuniteteve me banim në zonat rurale kanë plotësuar nevojat e tyre familjare për dru zjarri, lëndë ndërtimi apo gjethë për blektori nga pyjet në afërsi të fshatit apo zonës së tij. Ky

Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale”.

përdorim tradicional i pyjeve dhe kullotave ka patur qasje të ndryshme në zona dhe rajone të ndryshme të vendit. Në të shumtën e rasteve, ndërhyrjet e kryera në fondin pyjor e kullostor për plotësimin e nevojave të familjeve dhe komuniteteve nuk është bërë në përputhje me ligjin dhe po ashtu pa u evidentuar dhe formalizuar, si dhe pa u përditësuar të dhënat në regjistrin kombëtar kadastral për ndryshimet e kryera. Aktualisht në shumë prej sipërfaqeve pyjore, ndodhemi përparrë një situate faktike ku familjet që jetojnë në zonat rurale, janë kujdesur, e kanë ruajtur dhe kryer shërbime përmirësuese ndaj këtyre sipërfaqeve pyjore, por nga ana tjetër nuk kanë patur ligjërisht të drejtën për t'i përdorur ato.

Politikat e ndjekura për decentralizimin e qeverisjes së pyjeve dhe kullotave kanë synuar për afrimin e pyjeve dhe kullotave sa më afër me familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale, në mënyrë që ato t'i trajtojnë pyjet e kullotat si burime të mirëfillta, për të cilat duhet të kujdesen në ruajtjen dhe përmirësimin e tyre, por nga ana tjetër edhe të mund të përsitojnë prej tyre. Gjithashtu, edhe eksperiencia e ndjekur gjatë implementimit të projekteve të mbështetura nga Banka Botërore, Qeveria Suedezë e Fondi Global për Mjedisin kanë synuar të zbatojnë modele të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave më pjesëmarrje të komunitetit.

I gjithë procesi i decentralizimit të kalimit të pyjeve dhe kullotave fillimisht në përdorim ose pronësi të komunave dhe me vonë të delegimit të përgjegjësive të administrimit të pyjeve dhe kullotave tek 61 bashkitë e krijuara pas ndarjes së re territoriale të vitit 2015, si dhe krijimi i strukturave përgjegjëse për pyjet në bashki, ka krijuar një realitet të ri në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në nivel lokal.

Në vijim të sa më sipër, objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë:

- përcaktimi i kritereve dhe rregullave për dhënen në përdorim të pyjeve dhe kullotave tek familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale.
- formalizimi i të drejtave të përdorimit duke synuar që familjet që kanë përdorur tradicionalisht pyjet dhe janë kujdesur për to, të kenë mundësi për t'i marrë në përdorim këto sipërfaqe për një periudhë të caktuar kohore.
- njojja e të drejtës së përdorimit, e cila do të sigurojë më shumë mundësi për kryerjen e shërbimeve përmirësuese për këto pyje që kanë të identifikuar përdoruesit tradicional.

Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënen në përdorim të fondit pyjor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin Analistik të Projektakteve, përvitin 2023, katërmujori II, i cili del në zbatim të nenit 12, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi gjen mbështetje dhe është në një linjë me përcaktimet/drejtimet e dhëna nga dokumente të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, si VKM nr.814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”.

Gjithashtu, projektvendimi është hartuar në përputhje me parashikimet e dokumenteve sektoriale që ndërthuren me pyjet.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pyjet si pasuri kombëtare, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe progresin e vendit, ndaj duhen pozicionuar në një linjë me politikat dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar, me kontribut të qenësishëm, duke zhvilluar sektorin nëpërmjet një sistemi të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, strategjive, programeve, dhe planeve të mbarështimit, duke integruar dhe optimizuar interesat midis përdoruesve dhe mundësive të përdorimit/ shfrytëzimit të fondit pyjor.

Aktivitetet e planifikuara për t'u zhvilluar mbi fondin pyjor, duhet të programohen e standartizohen, më qëllim plotësimin e nevojave vetjake të familjeve dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë kuadër, përdorimi i fondit pyjor në bazë të rregullave dhe kritereve të përcaktuara në ligj, garanton jo vetëm mbrojtjen e zhvillimin e tij por njëkohësisht, është burim i mirëfilltë për sigurimin e të ardhurave, rritjen e mirëqqnies, hapjen e vendeve të reja të punës dhe ka impakt të drejtpërdrejtë në zbutjen e varfërisë të zonave rurale.

Propozimi i këtij vendimi synon të përcaktojë kriteret dhe rregullat për përdorimin e sipërfaqeve të fondit pyjor, në përputhje me autorizimin ligjor sipas pikës 4 të nenit 12, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”. Gjithashtu, miratimi i këtij vendimi del si domosdoshmëri për lehtësimin e

Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale”.

strukturave menaxhuese të kullotave në një qeverisje më të mirë dhe të drejtë të fondit kulloso kombëtar, në përgjigje të nevojave të komunitetit për dru zjarri, lëndë ndërtimi, gjethë për blegtori, bimë mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore etj. Përmes këtij projekt akti do të bëhet formalizimi i ndërhyrjeve që do të shkaktohen në fondin pyor nga ana e familjeve dhe komuniteteve me banim të pérhershëm në zonat rurale, si dhe do të synohet ruajtja e ekuilibrave natyrorë, mbrojtja e biodiversitetit dhe shtimi i vlerave ekologjike, në përputhje të plotë me objektivat e planeve të mbarështimit e zhvillimit të tyre.

Për sa më sipër, vendimi i propozuar do të sjellë një administrim më të mirë të sektorit dhe fondit pyor kombëtar, duke patur si pritshmëri për të ardhmen, mundësimin e efekteve financiare pozitive në sektor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës, në pikën 4 të nenit 12, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për Pyjet” dhe është në harmonizim me kuadrin ligjor në fuqi për pyjet.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis e BE-së*, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Sa i përket formës së projektvendimit, sqarojmë se projektvendimi është i strukturuar me pika, në 4 Krerë dhe 1 Shtojcë, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për shkak të përmbajtjes së shkurtër të dispozitave.

Në kreun I përcaktohet objekti dhe përkufizimet në kuptim të këtij vendimi.

Në kreun II, përcaktohen kriteret për dhënien në përdorim të sipërfaqes së fondit pyor për familjet dhe komunitetet me banim të pérhershëm në zonat rurale, si më poshtë:

- përdoren vetëm për përbushjen e nevojave vetjake të familjeve dhe komuniteteve me banim të pérhershëm në zonat rurale;

Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të pérhershëm në zonat rurale”.

- kanë një sipërfaqe jo më pak se 0.5 hektar;
- menaxhohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në planet e mbarështimit të vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për pyjet.
- ndodhen në njësinë administrative (fshatin) ku ka vendbanimin kërkuesi që kërkon të marrë fondin pyor në përdorim;
- shfrytëzohen vetëm për plotësimin e nevojave të komunitetit rural përfurnizimin me dru zjarri, e lëndë ndërtimi përiparimin e banesave, si dhe për krasitje përgjethë, me qëllim sigurimin e bazës ushqimore përblegtorinë, bimë mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore.

Në kreun III, parashikohen rregullat për dhënien në përdorim të fondit pyor për nevojat e familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale, si vijon:

- E drejta e përdorimit të sipërfaqes së fondit pyor kombëtar, i jepet familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale, për nevojat e tyre vetjake, në përbushje të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, duke konsideruar edhe respektimin e barazisë gjinore.
- Kërkuesi që merr në përdorim sipërfaqen e fondit pyor dhe gjëzon frytet që rrjedhin prej tij, ka detyrimin të përbushë detyrimet e kontratës së lidhru me bashkinë, të mos ndryshojë destinacionin e përdorimit dhe të mos zvogëlojë sipërfaqen e fondit pyor.
- Në rastet kur ka më shumë se një kërkues për të njëjtën sipërfaqe pyjore që kërkohet të merret në përdorim, përparësi ka kërkuesi që është përdorues tradicional. Gjithashtu, sipërfaqet që jepen në përdorim të shfrytëzohen në përputhje me kërkeshat ligjore dhe teknike të shfrytëzimit të pyjeve.
- Në rast të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur midis palëve nga kërkuesi, bashkia ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës, në përputhje me kërkeshat e legjislacionit në fuqi.
- Kërkuesi që kërkon të marrë në përdorim pjesën e fondit pyor kombëtar, paraqet kërkeshën me shkrim pranë strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki (në vijim, SPPB). Kërkesa me shkrim dorëzohet pranë SPPB të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të veprimtarisë së planifikuar.
- Kërkesa me shkrim shoqërohet me informacionin e nevojshëm, sipas shtojcës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- Sipërfaqja e fondit pyor kombëtar jepet në përdorim për një afat jo më shumë se 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi të kontratës së lidhur midis palëve.
- Sipërfaqet e fondit pyor kombëtar, të dëmtuara nga zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, ose nga shkaqe të tjera, kanë prioritet në dhënien në përdorim.

Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale”.

- Për bashkitë që nuk arrijnë të përmbushin nevojat për dru zjarri për familjet dhe komunitet e tyre zbatohen rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për pyjet.
- Ajo cka është e rendësishme dhe është përcaktuar në këtë vendim është edhe parashikimi që: Në rastet kur ka më shumë se një kërkues për të njëjtën sipërfaqe pyjore, ka përparësi për dhënien në përdorim për plotësim të nevojave vetjake të familjeve në nevojë:
- kërkuesi, kur ai është kryefamiljar femër;
- familjet me të ardhura më të ulëta ekonomike;
- kërkuesi, kur ai është përdorues tradicional i asaj sipërfaqeje.

Në **kreun IV**, përcaktohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Shtoja I, paraqet formatin e kërkesës për marje në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, njësitet e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtoria e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore), me asistencën e projektit “Promovimi i rimëkëmbjes së gjelbër në sektorin e pyjeve në Shqipëri” të financuar nga UNDP.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në ministritë e linjës, nëpërmjet sistemit *e-aktet*, konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për shqyrtim nga Këshilli Konsultativ.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale”.

Zbatimi i projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**PROPOZUESI
MINISTËR
Mirela KUMBARO FURXHI**



Relacion shpjegues për Projekvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhëni në përdorim të fondit pyjor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale”.